

## Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së zhvillon takimin me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura

### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2017
- Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 31 mars 2017
- Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 31 mars 2017

### Zhvillime të tjera

- Zhvillohet takimi i përvitshëm midis autoriteteve mbikëqyrëse të Shqipërisë dhe të Austrisë, AMF dhe FMA, për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve
- Seminar për mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet mbikëqyrjes, inspektimeve dhe ekzaminimeve
- Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Sigurimet gjithëpërfshirëse dhe mikrosigurimet” - sfidat për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe rajonin e Transkaukazit”
- Zhvillohet Mbledhja Vjetore e IOSCO-s “Ndërtimi i elasticitetit të tregut të kapitaleve në kohën pas krizës financiare”
- Mbi publikimin e vlerësimit vjetor për Shqipërinë nga Bashkimi Evropian
- AMF merr pjesë në Forumin Ndërkombëtar të Sigurimeve

### Edukimi i Konsumatorit

- *Metamorfoza e Greqisë dhe roli i industrisë së sigurimeve – Kujdestarët e së ardhmes? Fjala e Z. Yannis Stournaras, Guvernator i Bankës së Greqisë, mbajtur gjatë Forumit të Parë mbi sigurimet organizuar nga “Ekonomisti” në Athinë, më 30 mars 2017 (Marrë me shkurtime dhe redaktime – pjesa e dytë)*

### Lajme Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë
- Bullgari
- Kosovë
- Kroaci
- Maqedoni
- Mali i Zi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së zhvillon takimin me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së Z. Ervin Koçi zhvilloi në datat 2-3 maj 2017 takime me drejtues të subjekteve të mbikëqyrura nga AMF, që operojnë në tregun e sigurimeve, fondeve vullnetare të pensionit, bankave depozitare dhe përfaqësues të tjerë të tregjeve financiare jobankare.

Duke përshëndetur përfaqësuesit e shoqërive të sigurimit të mbikëqyrura, Z. Koçi evidentoi nevojën që AMF dhe shoqëritë të bashkëveprojnë që tregu i sigurimeve të bëhet sa më tërheqës për konsumatorin, duke zhvilluar produktet ekzistuese dhe duke krijuar produkte të reja. Përpjekja jonë e përbashkët, theksoi Z. Koçi, është që ta bëjmë tregun e sigurimeve të krahasueshëm me vendet e rajonit, në madhësinë dhe depërtimin e tij te konsumatori, duke rritur në të njëjtën kohë besimin e tij në këto tregje. Ai theksoi edhe rëndësinë e përmirësimit të bazës ligjore për tregun e sigurimeve, duke kërkuar bashkëpunim të ngushtë me të gjitha shoqëritë e sigurimeve që operojnë në treg. Një aspekt tjetër mjaft i rëndësishëm që u theksua ishte puna e madhe që duhet bërë për të rritur nivelin e kulturës financiare të popullsisë, duke i shërbyer kështu zgjerimit të tregut.

Ajo që është shumë e rëndësishme dhe emergjencë për zgjidhje nga të gjithë ne, theksoi Z. Koçi, është shlyerja sa më e shpejtë e detyrimeve të prapambetura, objekt i Fondit të Kompensimit. Gjithashtu ai garantoi që brenda muajit nëntor do të përgatiten ndryshimet ligjore të kuadrit rregullator, me qëllim që t'i shërbehet zhvillimit të tregjeve financiare.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv vuri theksin në shëndoshjen financiare të shoqërive nga njëra anë dhe kryerjen e pagesave në kohë të dëmeve për të gjithë të siguruarit.

Drejtimesit e shoqërive të sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës, të pranishëm në takim, shprehën problematikat që hasin në aktivitetin e përditshëm dhe kërkesën që baza ligjore e miratuar të pasqyrojë zhvillimet aktuale të tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Ata theksuan nevojën e mbështetjes në promovimin e produkteve të reja të sigurimit, siç është rasti i sigurimit nga fatkeqësitë natyrore si një produkt i nevojshëm veçanërisht për popullsinë e atyre zonave që kanë një shkallë të lartë risku.

Në takimin me përfaqësuesit e shoqërive të tregut të pensioneve vullnetare dhe të fondit të investimeve Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv vlerësoi rëndësinë që ka fondi i pensioneve vullnetare, i cili siguron mundësi më të mira financiare në kohën e daljes në pension dhe shërben si një valvul lehtësuese për efektet sociale nga skemat e pensioneve shtetërore.

Përfaqësuesit e fondeve të pensioneve u shprehën se ato janë duke forcuar pozitat e tyre në treg, por mbetet ende shumë punë për të bërë. Ndërkohë që ata

Përpjekja jonë e përbashkët, theksoi Z. Koçi, është që ta bëjmë tregun e sigurimeve të krahasueshëm me vendet e rajonit, në madhësinë dhe depërtimin e tij te konsumatori, duke rritur në të njëjtën kohë besimin e tij në këto tregje.

Z. Koçi theksoi se është ngritur grupi i punës për ndërtimin e strategjisë trevjeçare për ndërgjegjësimin publik dhe rritjen e besimit tek tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së.

shikojnë shumë të nevojshme miratimin e ndryshimeve ligjore të propozuara për lehtësimin e barrës fiskale për anëtarët e fondeve të pensioneve vullnetare.

Si një treg mjaft i rëndësishëm Z. Koçi vlerësoi dhe tregun e fondeve të investimeve dhe potencialin që ai ka për zgjerim. Ai vuri në dukje rëndësinë që ka rritja e kulturës financiare edhe për këtë treg.

Në përfundim të takimit, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi bëri me dije se stafi i AMF-së ka filluar punën për hartimin e një strategjie pesëvjeçare për zhvillimin e tregjeve të sigurimeve dhe financiare në vend dhe kjo strategji do të përcaktojë rrugën ku do të ecet për zhvillimin e këtyre tregjeve dhe rolin e çdo aktori të këtij tregu. AMF po shfrytëzon në këtë kohë edhe bashkëpunimin me projektin e mbështetur nga Sekretariati i Shtetit Zvicëran për Çështjet Ekonomike (SECO) në lidhje me ndihmën që ata japin, si për anën legjislative, ashtu dhe atë organizative të AMF-së.

Në të njëjtën kohë Z. Koçi theksoi se është ngritur grupi i punës për ndërtimin e strategjisë trevjeçare për ndërgjegjësimin publik dhe rritjen e besimit tek tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Z. Koçi theksoi vullnetin e AMF-së për të bashkëpunuar ngushtësisht me shoqëritë e tregut, duke krijuar sinergjinë e nevojshme për përmbushjen e misionit të mbrojtjes së konsumatorit dhe investitorit në treg, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

# **VËSHTRIM MBI TREGJET**

## **Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2017**

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-prill 2017 kapën vlerën mbi 4.75 miliardë lekë, ose 13.88% më shumë se gjatë periudhës janar-prill 2016. Gjatë periudhës janar-prill 2017, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 361,026 me një rritje prej 19.97%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 70.90%, në krahasim me periudhën janar-prill 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.06 miliardë lekë, apo 55.61% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### **Sigurimi i Jo-Jetës**

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 13.44% gjatë periudhës janar-prill 2017, krahasuar kjo me periudhën janar-prill 2016.

### **Sigurimi i detyrueshëm motorik**

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 2.77 miliardë lekë gjatë periudhës janar-prill 2017, duke shënuar një rritje prej 12.13% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 58.36% të tregut të sigurimeve.

### **Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës**

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 14.12% të tregut të Jo-Jetës;
- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 10.55 % të tregut të Jo-Jetës;


### **Sigurimi i Jetës**

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës gjatë periudhës janar-prill 2017 u rritën me 27.77% krahasuar me periudhën janar-prill 2016. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 67% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 2.77 miliardë lekë gjatë periudhës janar-prill 2017.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-prill 2017

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



## Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 31 mars 2017

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve “Raiffeisen Prestigj”, Fondi i Investimeve “Raiffeisen Invest Euro” të cilat administrohen nga shoqëria “Raiffeisen Invest” dhe Fondi i Investimeve “Credins Premium” nën administrimin e shoqërisë administruese “Credins Invest”.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.03.2017, vlera neto e aseteve të fondeve, arriti rreth 70.84 miliardë lekë, me një rritje prej 5.4 miliardë lekë ose 8.27% krahasuar me 31.12.2016.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 60.29% të aseteve të fondeve, me një rritje prej 1.45% krahasuar me 31.12.2016.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 31.03.2017 është 31,235 me një rritje prej 6.72% krahasuar me 31.12.2016. Rreth 99.98% e anëtarëve në fond janë investitorë individualë.

## Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 31 mars 2017

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.03.2017 tregon një total asetesh neto prej 1,407.17 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 88.43 milionë lekë (6.71%) krahasuar me fundin e vitit 2016. E shprehur në euro, totali i aseteve neto është 10.34 milionë euro.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.03.2017, vlera neto e aseteve të fondeve, arriti rreth 70.84 miliardë lekë, me një rritje prej 5.4 miliardë lekë ose 8.27% krahasuar me 31.12.2016.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 31.03.2017 ishte 18,487 anëtarë duke shënuar rritje prej 6.76% krahasuar me fundin e vitit 2016.

## Tregues të fondeve të pensioneve

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (mln. lekë)</i>		<i>Ndryshimi (Në %)</i>
	<i>31.12.'16</i>	<i>31.03.'17</i>	
Asetet neto të FP	1,318.74	1,407.17	6.71

## Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve


31.03.2017

<i>Fond Pensioni</i>	<i>Numri i anëtarëve në FP</i>	<i>Asete Neto (mln. lekë)</i>
SIGAL	5,880	714.93
RAIFFEISEN	2,654	431.09
SiCRED PENSION	9,953	261.15
<b>TOTAL</b>	<b>18,487</b>	<b>1,407.17</b>

## Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve

31.03.2017


(Në %)



## Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve

31.03.2017

(Në %)



<http://www.bankofalbania.org/> Kursi zyrtar i këmbimit ("fiksi") 31.03.2017 në Bankën e Shqipërisë.  
1 euro = 136.13 lekë

# ZHVILLIME TË TJERA

## Zhvillohet takimi i përvitshëm midis autoriteteve mbikëqyrëse të Shqipërisë dhe të Austrisë, AMF dhe FMA, për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve

Në vijim të bashkëpunimit për çështjet e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dhe fondeve të pensioneve private ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), një delegacion nga ky institucion zhvilloi takime pune në Tiranë në datat 3-4 maj 2017. Delegacioni kryesohej nga Z. Peter Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit në Austri.

Z. Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA, zhvilloi për gjatë dy ditëve takime pune me Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së dhe disa ekspertë të Autoritetit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv pasi shprehu falenderimin për asistencën e vazhdueshme nga FMA shprehu angazhimin dhe nevojën për forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.

Gjatë takimeve u diskutua për çështje të rëndësishme të interesit të përbashkët si dhe u pasqyruan zhvillimet e fundit për tregjet e sigurimeve të Austrisë dhe Shqipërisë.

Gjatë takimeve u diskutua për çështje të rëndësishme të interesit të përbashkët si dhe u pasqyruan zhvillimet e fundit për tregjet e sigurimeve të Austrisë dhe Shqipërisë. Ndërmjet të tjerash, takimet u përqendruan në zhvillimet e reja të tregut të sigurimeve gjatë zbatimit të *Solvency II* në tregjet që mbikëqyren.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv tregoi nevojën e madhe që AMF ka për asistencë në fillimin e procesit të implementimit të *Solvency II* dhe trajnimin e personelit veçanërisht në drejtim të mbikëqyrjes së tregjeve. Një çështje me mjaft interes nga të dyja palët ishte dhe mundësia e organizimeve të inspektimeve të përbashkëta në shoqëritë me kapital austriak që operojnë në tregun shqiptar.

Përfaqësuesit austriakë u treguan të gatshëm që të asistojnë AMF në kërkesat e saj dhe u vendosën pika kontakti për të konkretizuar çdo kërkesë dhe shkëmbim informacioni.

Të dy institucionet kanë, që prej vitit 2009, një marrëveshje bashkëpunimi, e lidhur menjëherë pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri, në kuadër të së cilës zhvillojnë takime periodike dypalëshe.



## Seminar për mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet mbikëqyrjes, inspektimeve dhe ekzaminimeve

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (*International Organization of Securities Commission, IOSCO*), zhvilloi gjatë periudhës 3-5 maj 2017, në Madrid, Spanjë, trajnimin me temë “Mbrojtja e konsumatorit nëpërmjet mbikëqyrjes, inspektimeve dhe ekzaminimeve”. Në këtë trajnim merrnin pjesë 83 përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore. Gjatë trajnimit u bënë prezantime nga lektorë të ndryshëm, përfaqësues të IOSCO-s apo të rregullatorëve më të zhvilluar, si dhe u zhvilluan punime në grup dhe raste studimi, rezultatet e të cilave u diskutuan pas çdo seance. Temat e trajtuara nga lektorët paraqitën shumë interes nga gjithë pjesëmarrësit.

Ndër temat kryesore që u trajtuan gjatë këtij trajnimi ishin:

**Mbikëqyrja, Inspektimet dhe Ekzaminimet.** Përmbajtja kryesore e kësaj teme ishte përgatitja përpara inspektimeve dhe ekzaminimeve duke përcaktuar pse po kryhet një inspektim apo ekzaminim, kur është periudha më e përshtatshme për tu kryer dhe kush duhet inspektuar, si dhe çfarë duhet parë gjatë inspektimit. Gjithashtu u trajtuan qëllimet kryesore të një inspektimi, qasja që duhet ndjekur dhe fazat në të cilat duhet të kalojë.

**Instrumentet e Mbikëqyrjes kundrejt Instrumenteve të Zbatueshmërisë.** Për këtë temë u diskutuan mjetet dhe strategjitë që duhen ndjekur në mënyrë që të krijohet një program zbatueshmërie sa më efektiv.

**Përdorimi i të dhënave analitike në funksion të inspektimeve. Mjetet dhe teknikat për hetimet rregullatore.** Nëpërmjet kësaj teme u diskutua mbi të dhënat kryesore që duhen përdorur në funksion të inspektimit, pse këto të dhëna kanë fituar rëndësi të veçantë për rregullatorët, kush janë aktorët kryesorë të inspektimit, cilat janë aftësitë e duhura, si duhen përdorur të dhënat analitike në mënyrë që të përmbushet objektivi i inspektimit. Gjithashtu u ilustruan mjetet dhe teknikat që duhen përdorur gjatë inspektimeve dhe ekzaminimeve.

**Ndërhyrjet e duhura, përgatitja dhe kryerja e një inspektimi apo ekzaminimi.** Tema shtjelloi objektivat e ndërhyrjes, si duhen mbajtur ekuilibrat, rastet kriminale dhe nevoja për ndërhyrje penale, mënyrat e parandalimit, llojet e intervistave që duhen kryer, si dhe hapat që duhen ndjekur.

Temat e mësipërme u shoqëruan me diskutime nga pjesëmarrësit në konferencë si dhe me prezantime të rasteve të ndryshme nga lektorët. Gjithashtu u prezantuan raste konkrete studimore dhe u diskutuan rezultatet e tyre midis pjesëmarrësve dhe lektorëve.

Gjatë trajnimit u bënë prezantime nga lektorë të ndryshëm, përfaqësues të IOSCO-s apo të rregullatorëve më të zhvilluar, si dhe u zhvilluan punime në grup dhe raste studimi, rezultatet e të cilave u diskutuan pas çdo seance.



## Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Sigurimet gjithëpërfshirëse dhe mikrosigurimet” - sfidat për Evropën Qendrore e Lindore dhe rajonin e Transkaukazit”

Në datat 17 maj 2017 u zhvillua në Lubljanë, Slloveni, Konferenca “Sigurimet gjithëpërfshirëse dhe mikrosigurimet (*Inclusive Insurance & Microinsurance*). Konferenca u organizua nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (AZN). Qëllimi i saj ishte prezantimi i konceptit të Sigurimit Gjithëpërfshirës dhe Mikrosigurimit, ose sigurimit për shtresat e popullsisë me të ardhura të ulëta. Konferenca theksoi gjithashtu edhe nevojën e aplikimit të skemave të sigurimit, në mënyrë që mos të ketë shtresa të popullsisë apo segmente të tregut të pasiguruar sipas motos “Mos lër askënd pas” (*Leave no one behind*). Nëpërmjet konferencës u synua fillimi i një dialogu mbi mikrosigurimin në të gjithë rajonin e Evropës Qendrore dhe Evropës Lindore.

Panelistë të ndryshëm nga institucionet mbikëqyrëse të tregut, organizatat ndërkombëtare në sigurime, hartues të politikave në sigurime, etj. si AMBEST, A2ii, ICIMF, IAIS, ICODA, EIOPA, prezantuan tematika të ndryshme mbi sigurimet. Ndër çështjet kryesore që u prezantuan, mund të veçohen:

- Shkaqet kryesore që një pjesë e mirë e popullsisë është e pasiguruar apo e nënsiguruar janë: mungesa e besimit, të ardhurat tepër të ulëta për të blerë sigurim, mungesa e produkteve të përshtatshme të sigurimit sipas zonave, mungesa e ndërgjegjësimit ndaj nevojës për të qenë i siguruar;
- Produktet tradicionale të sigurimit blihen kryesisht nga pjesa e popullsisë që qëndron në majë dhe në mes të piramidës së mirëqenies financiare. Produktet tradicionale të sigurimit janë të shtrenjta, ndërkohë që edhe pjesa e popullsisë me të ardhura të ulëta ka nevojë për t’u siguruar;
- Hapi i parë drejt mikrosigurimit është përcaktimi i targetit të tregut, por shumica e popullsisë është një target i përshtatshëm për mikrosigurimin;
- Një target i vlefshëm për mikrosigurim janë individët, fermerët, por edhe bizneset e vogla dhe të mesme, dhe jo domosdoshmërisht shtresat me të ardhura të pamjaftueshme për t’u siguruar, por edhe ajo pjesë e popullsisë me shkollim të ulët;
- Në skemat e mikrosigurimit, përfshirja e shtresave që janë në fund të piramidës (ata me të ardhura nën nivelin e varfërisë), realizohet vetëm me ndërhyrjen e qeverisë;
- Me shtrirjen e mikrosigurimit me tej, rriten edhe rreziqet dhe për rrjedhojë edhe kostot, por shfrytëzimi i teknologjisë sjell një avantazh të madh në uljen e tyre;
- Në hartimin e *Solvency II*, sigurimit gjithëpërfshirës dhe mikrosigurimit nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme.

Konferenca theksoi nevojën e aplikimit të skemave të sigurimit, në mënyrë që mos të ketë shtresa të popullsisë apo segmente të tregut të pasiguruar sipas motos “Mos lër askënd pas” (*Leave no one behind*).

Në konferencë u theksua se mikrosigurimi brenda rajonit të Evropës Qendrore e Lindore mund të jetë mjaft i rëndësishëm pasi në këto vende ka grupe të mëdha të popullsisë që janë të pasiguruara apo të nënsiguruara. Përfshirja e këtyre grupeve të popullsisë mund të sigurohet nëpërmjet uljes së kostove për produktet ekzistuese apo edhe krijimi i produkte të reja sigurimesh të rëndësishme për segmentet e shoqërisë me të ardhura të ulëta.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u prezantua në këtë konferencë nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes.

## **Zhvillohet Mbledhja Vjetore e IOSCO-s “Ndërtimi i elasticitetit të tregut të kapitaleve në kohën pas krizës financiare”**

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) zhvilloi në datat 14-18 maj 2017, Konferencën Vjetore, e cila u organizua në Montego Bay, Xhamajka nga Komisioni i Shërbimeve Financiare i këtij vendi. Në këtë konferencë merrnin pjesë përfaqësues nga 400 rregullatorë të letrave me vlerë, përfaqësues të kësaj industrie dhe pjesëmarrës të tjerë të tregut financiar nga e gjithë bota.

Gjatë tre ditëve, Bordi i IOSCO-s, Komiteti i Tregjeve në Zhvillim, katër Komitete Rajonale si dhe Komiteti Konsultativ i Anëtarëve, diskutuan në lidhje me iniciativat e tyre me qëllim mbrojtjen e investitorëve, sigurimin e tregjeve efeciente dhe transparente, si dhe zbutjen e riskut sistemik. Në disa nga seksionet, IOSCO u fokusua në sfidat e forcimit të tregut, adresimin e etikës financiare si dhe financimin e ekonomisë reale përmes tregjeve të kapitalit.

Në mënyrë të veçantë, Konferenca Vjetore e IOSCO-s adresoi sfidat kryesore me të cilat përballen tregjet e letrave me vlerë në një kohë që përgatiten të luajnë një rol më të madh në financimin e ekonomisë globale. Këto sfida përfshijnë zbutjen e risqeve lidhur me sigurimin e rrjeteve kompjuterike, ndryshimin e strukturës së tregut si dhe teknologjinë financiare.

Në fushën e menaxhimit të aseteve, Bordi adresoi iniciativat e tij mbi menaxhimin e riskut të likuiditetit të skemave kolektive të investimit. Këto iniciativa janë pjesë e përpjekjeve të IOSCO-s për të çuar përpara rekomandimet e Bordit të Stabilitetit Financiar (FSB) për adresimin e dobësive të mundshme lidhur me aktivitetin e menaxhimit të aseteve.

Një fokus i veçantë iu kushtua trajtimit të rolit të rregullimit në teknologjinë dhe automatizimin financiar. Një përfaqësues nga industria prezantoi për Bordin një kuadër të mundshëm për përdorim nga rregullatorët lidhur me testet të cilat lejojnë firmat në industrinë financiare për të vlerësuar sistemet e tyre dhe kontrollet, që të identifikojnë dobësitë dhe të forcojnë infrastrukturën e tyre kundrejt kërcënimeve të rrjetit kompjuterik.

Konferenca Vjetore e IOSCO-s adresoi sfidat kryesore me të cilat përballen tregjet e letrave me vlerë në një kohë që përgatiten të luajnë një rol më të madh në financimin e ekonomisë globale.

Bordi ra dakord për planin e punës 2017-2018 të Komitetit të Vlerësimit, duke përfshirë këtu Monitorimin e Zbatimit të Standardeve (ISIM) të IOSCO-s në ndihmë të anëtarëve të IOSCO-s. Ky është një mekanizëm i përdorur nga IOSCO për të monitoruar zbatimin nga anëtarët e saj të Parimeve dhe Standardeve të përcaktuara nga IOSCO.

Komiteti i Presidentëve i përbërë nga të gjithë drejtuesit e vendeve anëtare, aprovoi gjatë Konferencës Vjetore, një rezolutë për të rishikuar Objektivat dhe Parimet e Rregullimit të IOSCO-s, duke i shoqëruar me metodologjinë për vlerësimin e zbatimit të këtyre parimeve.

Gjatë kësaj Konference Vjetore nënshkruan Memorandumin Multilateral të Mirëkuptimit të IOSCO-s (MMOU) edhe pesë anëtarë të rinj, duke e çuar numrin e nënshkruarëve në 114 nga 142 anëtarë të kësaj organizate. MMOU ekzistuese e IOSCO-s është përmirësuar dhe aprovuar në mars 2017. Ajo u plotësua me fuqi shtesë për të përkthyer forcimit të bashkëpunimit ndër kufitar dhe shkëmbimit të informacionit (e quajtur EMMOU). Anëtarët që do të aplikojnë për t'u bërë nënshkruar të EMMOU do të skanohen vetëm për elementët e rinj të kësaj marrëveshjeje.

## **Mbi publikimin e vlerësimit vjetor për Shqipërinë nga Bashkimi Evropian**

---

Duke vlerësuar ecurinë e Shqipërisë, raporti përshkruan se vendi “po përjeton një përmirësim gradual ekonomik që pritet të vazhdojë në periudhën 2017-2019”.

---

Përfaqësues të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, Komisionit Evropian dhe Bankës Qendrore Evropiane u takuan më datë 23 maj 2017 me homologët e tyre nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia në kuadër të dialogut të përvitshëm për politikën ekonomike. Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia kanë paraqitur programet e reformës ekonomike të cilat përfshijnë periudhën 2017-2019. Këto programe prezantojnë kuadrin afatmesëm fiskal dhe makroekonomik, si dhe një gamë të gjerë reformash strukturore për nxitjen e konkurrueshmërisë dhe rritjes ekonomike afatgjatë.

Duke vlerësuar ecurinë e Shqipërisë, raporti përshkruan se vendi “po përjeton një përmirësim gradual ekonomik që pritet të vazhdojë në periudhën 2017-2019”. Vlerësimi thekson se Shqipëria i ka zbatuar pjesërisht udhëzimet e përcaktuara në konkluzionet e Dialogut Ekonomik dhe Financiar të majit 2016.

Përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhanë gjashtë rekomandime për Shqipërinë në kuadër të Udhërrëfyesit Politik. Rekomandimi i tretë thekson ndër të tjera nevojën e rritjes së tregjeve financiare. Duke analizuar tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së, Shqipërisë i rekomandohet “të forcojë mbikëqyrjen e sektorit financiar jobankar, duke rritur kapacitetin e Autoritetit Mbikëqyrës Financiar.”

Raporti i plotë i vlerësimit gjendet në:

[https://eeas.europa.eu/delegations/albania/26758/node/26758\\_sq](https://eeas.europa.eu/delegations/albania/26758/node/26758_sq)

## AMF merr pjesë në Forumin Ndërkombëtar të Sigurimeve

—○○○—  
Në Forum, theksi u vu tek ndërlidhja që kanë tregjet financiare dhe ato të sigurimeve në veçanti me njëri tjetrin.  
—○○○—

Shoqata Kombëtare e Komisionerëve në Sigurime (*National Association of Insurance Commissioners, NAIC*) organizoi në datat 16-17 maj në Washington DC Forumin Ndërkombëtar të Sigurimeve. Në Forum ishin pjesëmarrës më shumë se 300 rregullatorë dhe sigurues nga 20 juridiksione që përfaqësonin më shumë se 70 për qind të primeve të sigurimit në nivel global. Pjesëmarrës në Forum ishin mjaft përfaqësues të autoriteteve rregullatore evropiane si edhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtare.

Gjatë diskutimeve në panele të ndryshme në Forum, theksi u vu tek ndërlidhja që kanë tregjet financiare dhe ato të sigurimeve në veçanti me njëri tjetrin. Presidenti i organizatës NAIC u shpreh se "Tregjet globale, ndonëse janë përherë të ndryshme, janë gjithnjë e më të ndërlidhura - ndërmjet vendeve, brenda rajoneve dhe me ndikime të tjera ekonomike dhe politike". Në sesione të veçanta diskutimi pati prezantime edhe nga përfaqësues të Autoritetit Europian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupation Pensions Authority, EIOPA*), Këshillit Mbikëqyrës të Stabilitetit Financiar (*Financial Stability Oversight Council, FSOC*), Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (*International Association of Insurance Supervisors, IAIS*) dhe Rezervës Federale të SHBA.

Temat kryesore të diskutuara përfshinin rrezikun sistemik, risigurimin dhe standardet ndërkombëtare të kapitalit. Mjaft nga rregullatorët në sigurime shkëmbyen përvojat e tyre lidhur me mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve.

## Metamorfoza e Greqisë dhe roli i industrisë së sigurimeve – Kujdestarët e së ardhmes?

### Fjala e Z. Yannis Stournaras, Guvernator i Bankës së Greqisë, mbajtur gjatë Forumit të Parë mbi Sigurimet organizuar nga “Ekonomisti” në Athinë, më 30 mars 2017

(Marrë me shkurtime dhe redaktime – pjesa e dytë)

Gjatë shtatë viteve të fundit, Greqia ka pësuar një ndryshim të thellë në formë, sikurse e përshkruan edhe fjala greke “metamorfoza”. Politikat e zbatuara në vitin 2010, në kuadër të tri programeve të rregullimit kanë ndihmuar në përballimin e mungesës së ekuilibrave të mëdha fiskale dhe ato të jashtëme, duke e kthyer deficitin dyshifror në një bilanc pozitiv gjatë viteve të fundit. Krahas kësaj performance janë arritur përmirësime të konsiderueshme strukturore në tregjet e punës dhe të produkteve, si edhe në administratën publike.

Sidoqoftë, metamorfoza nuk është e plotë. Greqia nuk ka qenë ende në gjendje të kthehet në një rritje të qëndrueshme dhe një parakusht për këtë është përfundimi i shqyrtimit dhe zbatimi i vendosur i programit. Kjo është sfida aktuale, e cila e bën zbatimin e reformave strukturore të vështira dhe here pas here duke çuar në ndryshimin e politikave.

Vuajtja e gjatë e sistemit grek të pensioneve është një shembull kryesor në këtë aspekt. Që prej vitit 2010 janë zbatuar të paktën tre reforma të rëndësishme, por shumë dispozita mbeten ende për t'u zbatuar plotësisht, ndërsa sistemi mbetet i shtrenjtë, i deformuar dhe i padrejtë.

Vuajtja e gjatë e sistemit grek të pensioneve është një shembull kryesor në këtë aspekt. Që prej vitit 2010 janë zbatuar të paktën tre reforma të rëndësishme, por shumë dispozita mbeten ende për t'u zbatuar plotësisht, ndërsa sistemi mbetet i shtrenjtë, i deformuar dhe i padrejtë.

Në kushte aktuale, në mars 2017, nisi procesi tjetër i reformës së sistemit të pensioneve. Ky proces ishte i nevojshëm sepse, pavarësisht ndërhyrjeve të shumta të realizuara më parë, sistemi i pensioneve mbetet i kushtueshëm. Sipas raportit të buxhetit të shtetit 2017, buxheti i shtetit i transferoi fondit të sigurimeve sociale/EFKA shumën prej 7.6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në 2016 dhe pritet që kjo shumë të arrijë në 9.9% të PBB-së në 2017, pasi pensionet e nëpunësve civil ofrohen tashmë nga EFKA. Kjo bën që shuma e transferuar të jetë më shumë se një e treta e buxhetit të zakonshëm të shpenzimeve në vitin 2017.

Këto presione buxhetore mund të lehtësohen përmes rregullimeve të disa pensioneve. Kjo ndodh për shkak se, në disa raste, përfitimet e pensioneve, të para si nga këndvështrimi kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, janë mjaft bujare në Greqi. Në mënyrë të veçantë:

- Në disa raste, ato janë më të larta sesa kontributet që janë paguar për marrjen e tyre. Një studim i fundit, i kryer nga Njësia e Kërkimit për Analizën e Politikave pranë Universitetit të Athinës për Ekonominë dhe Biznesin, tregon se para ndryshimeve legjislative në periudhën 2010-2013 që bënë shkurtime të pensioneve të ndryshme, mesatarisht 50.7% e pensioneve nga IKA (*Social Security Organisation in Greece*) financohej nga kontributet, ndërsa pjesa e mbetur 49.3% financohej nga një transferim social, ose një subvencion i Qeverisë. Pas realizimit të shkurtimeve të pensioneve, në 2010-2013, subvencioni shtetëror ra në 35.8%.

—○○○—  
Siguria financiare e skemave të daljes në pension nuk duhet, dhe nuk mund të sigurohet nga një burim i vetëm: fondet e sigurimit social, planet e pensioneve të mbështetura nga punëdhënësi, dhe kursimet personale duhet të shihen si pjesë thelbësore dhe plotësuese e një sistemi të vetëm që siguron përballimin, përshtatshmërinë dhe qëndrueshmërinë financiare të sistemit.

—○○○—

- Bujaria relative e sistemit është reflektuar edhe në normat e larta të zëvendësimit bruto në krahasim me homologët evropian: shkalla bruto e zëvendësimit ishte rreth 81% në fund të vitit 2013, më e larta në zonën e euros, dhe pothuajse 30 pp (pike përqindje) më e lartë se mesatarja e shteteve të zonës euro.
- Të dhënat e publikuara kohët e fundit nga Eurostat tregojnë se në 2014 shpenzimi për pensionet në Greqi ishte më i larti në vendet e BE-së (13.3% të PBB-së, krahasuar me mesataren prej 9.8% të PBB-së së EU-28). Reformat e vitit 2015 dhe 2016 tentuan të kufizojnë më tej përfitimet e pensioneve, pasi u përjashtuan pensionistët e vjetër deri në korrik 2018. Si rezultat, rregullimi fiskal i dhënë nga reformat e fundit është mbartur nga gjeneratat e reja të pensionistëve me karrierën më të gjatë, duke përkeqësuar kështu lidhjet përfitime–kontribute, duke ngritur çështjet e barazisë në trajtimin e brezave.

Nga ana tjetër, sistemi financiar nuk mund të vetëfinancohet nëpërmjet rritjes së kontributeve. Kontributet e larta të sigurimeve shoqërore rriten barrën tatimore mbi punën dhe sollën në një periudhë afatmesme, rënien e PBB.

Ky mjedis i përshkruar më lart, me shkurtime të pensioneve, tregon se një sistem i sigurimeve shoqërore i përshtatshëm dhe në të njëjtën kohë, i qëndrueshëm nuk është i përballueshëm në rrethanat aktuale në Greqi. Përpjekjet për reforma janë të vështira, por mund të forcohen nga politikat që rrisin të ardhurat për pensionistët në të ardhmen, duke siguruar kështu rrjete të përshtatshme të sigurisë sociale dhe zbutjen e rezistencës sociale ndaj ndryshimeve. Politika të tilla përfshijnë zgjatjen e moshës në punë dhe rritjen e punësimit të punëtorëve më të vjetër, duke inkurajuar kursimet private. Gjithashtu politikat mund të integrojnë akumulimin e pensionit tuaj nga shtylla e parë e skemave publike me atë të pensioneve profesionale, të shtyllës së dytë dhe shtyllës së tretë të skemave të pensioneve personale.

Siguria financiare e skemave të daljes në pension nuk duhet, dhe nuk mund të sigurohet nga një burim i vetëm: fondet e sigurimit social, planet e pensioneve të mbështetura nga punëdhënësi, dhe kursimet personale duhet të shihen si pjesë thelbësore dhe plotësuese e një sistemi të vetëm që siguron përballimin, përshtatshmërinë dhe qëndrueshmërinë financiare të sistemit.

Në mënyrë që të formohet një sistem i integruar i tillë, të gjitha palët e interesuara duhet të kuptojnë rolet e tyre përkatëse: shteti nuk duhet të insistojë në mbajtjen e monopolit të përfitimeve të pensioneve; punëdhënësit nuk duhet të interpretojnë rolin e tyre në ofrimin e sigurisë për punonjësit vetëm gjatë kohës së tyre të punës, por duhet ta zgjerojnë atë më tej, kryesisht pas daljes në pension; dhe qytetarët nuk duhet të harrojnë rolin që luajnë kursimet personale në garantimin e sigurisë së tyre financiare të pensionit.

Përfitimet nga një sistem i pensioneve profesionale janë të qarta, mbi të gjitha ky sistem rrit burimet financiare të fuqisë punëtore, pas daljes në pension. Ai rrit



produktivitetin e fuqisë punëtore pasi përbën një mjet efikas për shpërblimet të tjera dhe në fund, rrit investimet totale në vend, duke vepruar si një alternativë për bankat, por si një mënyrë shumë efektive e financimit të ekonomisë reale.

Fondet e pensioneve profesionale (të quajtura ndryshe “*Institutions for Occupational Retirement Provision*”- Institucione për Sigurimin e Pensioneve Profesionale – IORP) u prezantuan në Greqi me Ligjin 3029/2002. Për fat të keq, legjislacioni aktual nuk përfshin dallimet delikate, por shumë të rëndësishme, të komponentëve të ndryshëm të një sistemi efektiv të pensioneve profesionale: ato midis një institucioni pensionesh, një fondi pensioni, një skeme pensioni dhe atë të subjektit që menaxhon fondet e pensioneve. Përveç kësaj, ai keqinterpretin rolin e institucionit pensional lidhur me përgjegjësitë që ka kundrejt anëtarëve të tij, duke i dhënë atyre kuptimin e gabuar, “si sigurim shoqëror” me mbrojtje të plotë, pavarësisht nga kapaciteti financiar i sponsorit. Së fundi, legjislacioni aktual nuk reflekton realitetin ekonomik grek, pasi barra ekonomike e krijimit të një fondi pensioni profesional është mjaft e madhe dhe e rëndë, edhe për punëdhënësit më të mëdhenj, për të mos përmendur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat përbëjnë shtyllën të ekonomisë greke.

Transpozimi në legjislacionin grek gjatë muajve të ardhshëm, i direktivës së re të BE-së "IORP's II", duhet të shihet si një mundësi për një metamorfozë të re, në mënyrë që sistemi i pensioneve profesionale të funksionojnë siç duhet dhe të përmbushë qëllimin e tij.

Transpozimi në legjislacionin grek gjatë muajve të ardhshëm, i direktivës së re të BE-së "IORP's II", duhet të shihet si një mundësi për një metamorfozë të re, në mënyrë që sistemi i pensioneve profesionale të funksionojnë siç duhet dhe të përmbushë qëllimin e tij. Unë jam i bindur se forca punëtore greke mund të arrijë përfitime të mëdha nga sistemi i pensioneve profesionale, dhe për këtë duhet:

- Të identifikohet dhe të njihet qartësisht roli i secilit komponent;
- Të rivendoset roli i institucionit të pensionit profesional si një kujdestar i premtimeve nga ana e punëdhënësit për punonjësit e tyre, duke mënjanuar tipare të tilla “si ato të sigurimeve shoqërore”;
- Të aplikohet fleksibilitet më i madh në përputhje me situatën reale të ekonomisë greke; Për shembull, ligji mund të lejojë më shumë se një punëdhënës (madje edhe nga sektorë të ndryshëm), secili me skemën e vet të pensioneve, që të kontribuojnë në të njëjtin fond pensionesh që operohet së bashku me fondet e tjera nga një njësi e vetme;
- Të certifikohet një subjekt i autorizuar i cili është përgjegjës për funksionimin e një institucioni pensionesh;
- Njohja e të drejtës së mobilitetit të pensionit;
- Në rastet e mungesës së aftësisë paguese të një institucioni IORP, të përcaktohen procedurat e likuidimit apo disbursimit të rregullt të benefiteve nga subjekti që menaxhon IORP; dhe
- Së fundi, por jo më pak e rëndësishmja, të eliminohet fragmentimi i panevojshëm i mbikëqyrjes së institucioneve IORP.



Vetëm në kushte të tilla, sistemet e pensioneve profesionale do t'i shërbejnë qëllimeve të tyre dhe sektori privat i sigurimeve mund të rimarrë rolin e tij në operimin e IORP-it, duke ofruar ekspertizën dhe përvojën e tij dhe t'i sigurojë vlerë të shtuar anëtarëve dhe përfituesve të sistemit.

(vijon)

## Bosnje-Hercegovinë

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sikurse tregojnë të dhënat nga agjencia e sigurimeve lokale-AZOBH (*Insurance Agency of Bosnia and Herzegovina*), volumi agregat i primeve të shkruara bruto i 27-të siguruesve që veprojnë në Bosnje-Hercegovinë u rrit me 6.4% në terma vjetorë, duke arritur në 634.1 milionë BAM (monedha lokale, Bosnian Convertible Mark) ose rreth 324.2 milionë euro. Vlera e primeve të shkruara bruto për 13 kompanitë që veprojnë në Federatën e Bosnje-Hercegovinës u rrit me 5.2% duke arritur në 228.4 milionë euro. Në Republikën Serbe të Bosnjës, 14 kompanitë e sigurimeve gjeneruan rreth 95.8 milionë euro, duke u rritur me 9.4% e shprehur në terma vjetore.

Volumi agregat i primeve të shkruara bruto përbëhej nga rreth 20.4% sigurime të Jetës, ekuivalente me 66.1 milionë euro. Nga klasat e sigurimit të Jo-Jetës, 8.4% e primeve të shkruara bruto i korrespondonin sigurimeve të pronës dhe 59.4% lidheshin me sigurimet motorike (Sigurimi Kasko dhe MTPL së bashku) duke arritur në një vlerë prej 192.6 milionë.

## Bullgari

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Rregullatori financiar i Bullgarisë, deklaroi të martën se përkohësisht ka ndaluar publikimin e një oferte blerje nga Euroins Insurance Group (EIG) për pjesën e mbetur prej 9.93% të kapitalit aksionar të Euroins siguruesit të bazuar në Sofje. Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare (*Financial Supervision Commission*) nuk dha detaje të mëtejshme për njoftimin.

Në muajin prill, EIG, pjesë e grupit financiar dhe të sigurimeve Eurohold Bullgaria, inicioi një ofertë blerjeje për një shifër prej 14,834,631 aksione në Euroins, të cilat ajo nuk i zotëronte, me një çmim prej 1.266 leu (afërsisht 0.72 \$ / 0.65 euro) secila. Më 31 mars, EIG ngriti interesin e saj aksionar në Euroins në më shumë se 90% të të drejtave të votës.

Tregu i sigurimeve në Bullgari e mbylli vitin 2016 me një rritje prej 4.4% të volumit të primeve të shkruara bruto krahasuar me vitin e kaluar duke arritur në 2.05 miliardë BGN (monedha lokale Levi Bullgar) ose rreth 1.05 miliardë euro.

Të dhënat paraprake të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë tregojnë se sigurimet e Jo-Jetës arritën një volum të primeve të shkruara bruto prej 829.5 milionë euro, duke u rritur me 3.1% në terma vjetore. Ky treg zinte 79% të tregut total të sigurimeve. Ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës arriti në 219 milionë euro ose 9.5% më shumë krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje i dedikohet më së shumti rritjes së segmentit të produkteve të sigurimit të Jetës të lidhura me investimet, të cilat patën një rritje prej më shumë se 116%.

## Kosovë

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas publikimeve të bëra nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) sektori i sigurimeve, që përfaqëson rreth 3% të totalit të aseteve të sistemit financiar, ka pasur një rritje vjetore prej 6.1% në dhjetor 2016.

Raporti i BQK-së për Vlerësimin Tremujor të Ekonomisë nënvizonte se "... një nga kontribuesit kryesorë në rritjen e aktiveve të sektorit të sigurimeve ishte rritja e parave të gatshme të mbajtura në bankat komerciale, që ka pjesën më të madhe në strukturën e aseteve të shoqërive të sigurimit. Sigurimi i Jo-Jetës, që përfaqëson sektorin më të madh prej rreth 89.9% të aseteve shënoi një rritje vjetore prej 5.8%. Ndërsa sigurimi i Jetës, që përfshin pjesën e mbetur të aseteve, pati një rritje prej 8.3%.

Sipas shifrave të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës, në fund të marsit 2017, tregu i sigurimeve në Kosovë arriti në 18.8 milionë euro. Nga ky volum total i primeve të shkruara bruto, sigurimet vullnetare zinin 43% dhe ato të detyrueshme 57%.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017 vlera e dëmeve të paguara arriti në 11.2 milionë euro, duke u rritur me gati 37%.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, siguruesit kosovarë realizuan rreth 181.9 mijë polica sigurimi prej të cilave vetëm 83.8 mijë ishin polica sigurimi të brendshëm TPL, 38.1 mijë ishin polica sigurimi kufitar, ndërsa rreth 60 mijë ishin polica të klasave të tjera të sigurimeve vullnetare.

## Kroaci

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të publikuara zyrtarisht, volumi i kombinuar i primeve të shkruara bruto të siguruesve kroatë, në fund të muajit prill 2017 arriti në vlerën e 3.3 miliardë HKR (monedha lokale Kuna) ose rreth 492.6 milionë USD ose 444.1 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 1.11% në vit.

Sipas shifrave të publikuara në faqen zyrtare online të Byrosë Kroate të Sigurimeve (*Croatian Insurance Bureau*) primet e shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës, në terma vjetorë, u rritën me 2% duke arritur në 2.3 miliardë HKR në fund të prillit. Sigurimet e Jetës sollën një volum të primeve bruto prej 1.0 miliardë HKR, i cili ishte 0.79% më i ulët se niveli i një viti më parë. Gjatë muajit prill 2017, në Kroaci vepronin 25 kompani sigurimi.

Sipas shifrave të paraqitura, shoqëria UNIQA Osiguranje, një njësi e grupit austriak të sigurimeve e bazuar në Austri është siguruesi më i madh në vend, e cila raportoi volumin më të lartë të primeve të shkruara bruto me rreth 29.9 milionë euro (9.2% të tregut). Ndërsa kompania më e madhe e sigurimeve në Republikën Serbe të Bosnje-Hercegovinës ishte WIENER Osiguranje, e cila është një njësi e VIG austriake, e cila arriti 16.1 milionë euro vlerë të primeve të shkruara bruto dhe duke pasur 5% të tregut.

## Maqedoni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Republikën e Maqedonisë u rrit me rreth 5% në vitin 2016 duke arritur në 8.7 miliardë dinarë (monedha lokale MKD) ose rreth 142 milionë euro. Sipas të dhënave të ofruara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, kjo shpreh një rritje prej 7.74% në numrin e kontratave të sigurimit të lidhura.

Duke u shprehur për Xprimm z. Klime Poposki, Kryetar i Këshillit të Ekspertëve, të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, ISA, tha se "Industria e sigurimeve pati një vit relativisht të suksesshëm, pavarësisht nga ndikimi i rreziqeve të natyrës jo ekonomike, industria kishte rritje të volumit të primeve të shkruara bruto, rritja e aseteve dhe rritja e investimeve, punësim më i lartë, si dhe rritja e numrit të ndërmjetësve të sigurimeve".

Volumi i primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës arriti në 7.43 miliardë dinarë ose rreth 121 milionë euro, me një rritje prej 3.5% krahasuar me vitin e kaluar. Ndërsa volumi i primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës arriti në 1.29 miliardë dinarë (21 milionë euro) me një rritje prej 17.32% krahasuar me vitin e kaluar.

Duke folur për ndryshimet e pritura rregullatore, kryetari i ISA të Maqedonisë tha se Agjencia ka në vazhdimësi një projekt binjakëzimi me BE, i cili ka si synim final hartimin e akteve rregullatore të harmonizuara me Direktivën *Solvency II*.

## Mali i Zi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve e Malit të Zi, volumi total i primeve të shkruara bruto për 11-të kompanitë e sigurimeve që operojnë në Malin e Zi është rritur me 3.8% mbi baza vjetore duke arritur në 17.4 milionë euro gjatë tremujorit të parë të vitit 2017.

Segmenti i sigurimit të Jo-Jetës arriti një total të primeve të shkruara bruto prej 14.4 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 3.3% në terma vjetorë. Ndërsa shoqëritë e sigurimit të Jetës patën një rritje prej 6.7% krahasuar me vitin e kaluar.

Shoqëria GRAWE Osiguranje, degë e kompanisë austriake GRAZER Wechselseitige Versicherung, ishte siguruesi më i madh i Jetës me një volum të primeve të shkruara bruto prej 0.9 milionë euro dhe zinte 31% të tregut.

Shoqëria LOVCEN Osiguranje, degë e grupit të sigurimeve sllovene TRIGLAV, ishte siguruesi më i madh i Jo-Jetës në Mal të Zi me volum të primeve të shkruara bruto prej 6.7 milionë euro duke zënë 46.2% të tregut.



Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)